Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0563

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj-Kryetare, Agon Ramadani Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatori Ekonomik (OE) "Ex Fis" SHPK, kundër Vendimin për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1, iniciuar nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a nga cilësia e saj si Autoriteti kontraktues (AK) më 20/10/2023, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik (OE) "Ex Fis" SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.08.2023 me numër protokolli 563/23 për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegës për kaldajë – Mazut (Fuel Oil 1%) " me nr. të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1, iniciuar nga Korporata Energjetike e Kosoves në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK).

2.Anulohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 01.08.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

3.Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4.Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 05.07.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lëndë djegëse për kaldajë - mazut (fuel oil 1%)" me numër të prokurimit KEK-23-6766-1-1-1.

Me datë 01.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Patroni".

Me datë 04.08.2023 operatori ekonomik ankues "Ex Fis" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 07.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues me datë 10.08.2023 kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2023/0563.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi i parë (I) -"*Vërejtjet te lista e furnizimeve të realizuara në vitet e fundit (2019, 2020, 2021): Kontrata e prezantuar mes OE Patroni NSH, ETI shpk, EKO CLEAN shpk, Carbon Petrol dhe Oil Petroll fillojnë dhe përfundojnë në të njëjtat data çka në këto raste te operatoret private është e pa mundur dhe e pa arsyeshme si dhe krijon dyshimin e një dokumenti fiktive, shto këtu edhe faktin që data 01.01. është ditë feste, pra dita e parë e vitit. Po ashtu kohëzgjatja e kontratave e prezantuar në këtë listë nuk përkon me kohëzgjatjen e kontratave të prezantuara. Pra AK duke mos i sqaruar dhe verifikuar këto kontrata por duke i marrë të mirëqena ka vepruar në kundërshtim me LPP nenin 72 dhe Rregulloren nr. 01/2022 nenin 38 par. 38.3, 38.4 dhe 38.5*".

Pretendimi i dytë (II) -"*Raporti i vlerësimit në faqen nr. 11 figuron se kërkesat e përshtatshmërisë si kërkohen në FDT nenin 6.4 pika 2 dhe 3 janë përmbushur nga OE i rekomanduar për kontratë me datë 24.07.2023 dhe me datë 25.07.2023 datë kur ZPP Ymer Dragusha e ka nënshkruar dhe aprovuar raportin e vlerësimit dhe rekomandimin e komisionit të vlerësimit duke vërtetuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar këtë gjitha kërkesat të DT. Ndërsa bazuar në dëshmitë e dorëzuar nga KEK Sh.A. figuron se AK ju ka drejtuar OE Patroni me dt. 01.08.2023 për të dorëzuar këto dëshmi, ndërsa mbështetur në origjinalet e këtyre dokumenteve figuron se këto dokumente janë nxjerrë me datë 01.08.2023 dhe si duket janë dorëzuar po me këtë datë te AK*".

Pretendimi i tretë (III) -"*ZPP ka pranuar si të mirëqenë dokumentin e OE Patroni të lëshuar nga Gjykata Komerciale me nr. GjA.nr.4574-23 dt. 01.08.2023, pa e analizuar dhe verifikuar nëse dokumenti i plotëson kërkesat e DT të përcaktuar në FDT neni 6.4 pika 3. Nëse e analizojmë këtë dokument dëshmohet se Gjykata Komerciale ka lëshuar garanci vetëm për paragrafin 4 nën paragrafin 4.1 dhe 4.2 të nenit 65 dhe nuk jep asnjë dëshmi apo garancion për kërkesat e paragrafit 3 të nenit 65, ashtu si kërkohet edhe në FDT neni 6.4 pika 3*".

Pretendimi i katër (IV) -"*Përmes DT kërkohet që fituesi potencial duhet të ketë kapacitete teknike për liferimin 250 tonëve për 5 ditë, në rastet emergjente 500 ton. Në dokumentet e ofertës se OE Patroni nuk figuron ndonjë dokument me të cilin OE dëshmon kapacitet e tij transportuese*".

Pretendimi i pestë (V) -*"Në aneksin 1 të DT është kërkuar që OE përmes një deklarate të deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin. Ndërsa në paragrafin e fundit të Aneksit 1 AK ka specifikuar që tenderuesi duhet të jetë në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë. Çdo kërkesë jo e përmbushur do të eliminojë tenderin për pjesën e plotë. Ju lutem kontrolloni nëse tenderi juaj plotëson secilin nga specifikimet teknike të përshkruara më lartë. Bazuar nga qasja që ne kemi pasur në dokumentet e këtij tenderi si dhe ofertën e OE Patroni, ne nuk kemi hasur së OE ka dorëzuar këtë deklaratë, apo ndonjë dëshmi tjetër ekuivalente qe do e përmbushë këtë kërkesë të DT. Ndërsa në kërkesën tonë për rishqyrtim përmes vendimit dt. 04.08.2023 lidhur me këtë pikë AK na është përgjigjur se OE i propozuar për kontratë në ofertën e tij ka dorëzuar një dokument me analiza fiziko-kimike në të cilin kuptohet vendi dhe origjina e lëndës djegëse-Mazutit. Dokumenti të cilit i referohet AK, nuk e plotëson kërkesën e AK sepse ky dokument është një Certifikatë e Kualitetit të cilën e ka lëshuar laboratori MAKINSPECT doo në Shkup për OE Patroni që dëshmon vetëm metodat e përdorura për analiza të një sasie prej 25.719 kg (ose 26,930 litra) Mazut që OE Patroni e ka blerë dhe ngarkuar në HELPE lonia, Thesaloniki. Në ketë çertifikatë nuk ceket as shitësi dhe as prodhuesi i mazutit. Si e tillë kjo certifikatë nuk e garanton as kualitetin e mallit të ofruar nga OE Patroni sipas kërkesave të DT aneksi 1 tabela e dytë, sepse kjo çertifikatë i referohet një sasise të caktuar mazuti të blerë (sasia prej 26,930 lirave) që OE Patroni e ka blerë me dt. 19.07.2023 dhe e ka destinuar në një vend tjetër dhe jo për KEK sha. Kur merret parasysh që OE Patroni nuk ka paraqitur fare Deklaratën për të dëshmuar vendin e origjinës së Mazutit dhe prodhuesin apo edhe ndonjë dëshmi tjetër ekuivalente si autorizim apo marrëveshje me ndonjë prodhues qe do të plotësonte kërkesën e deklaratës është plotësisht e qartë që OE i rekomanduar nuk mund të paraqes as çertifikatë valide mbi kualitetin e mallit e cila plotëson kërkesat teknike të ankesit 1. Pra kjo çertifikatë nuk mund të merret si dokument ekuivalent për deklaratën mbi vendin e*

origjinës së mazutit dhe prodhuesin por nuk mund të merret as si dokument valid për të dëshmuar karakteristikat e mallit sipas aneksit 1 tab. 2".

Pretendimi i gjashtë (VI) -"*Bazuar në ofertën financiare të OE Patroni, vërehet një dallim shumë i madhe në çmimin e primit mes ofertës tonë dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë. Mbështetur në faktet që ne i kemi dorëzuar në ofertën tonë me të cilat dëshmohet se EX FIS është operatori i vetëm i autorizuar nga Rafineria OKTA në Shkup deklarojmë me përgjegjësi të plotë se çmimi i ofruar ne OE Patroni është jo normalisht i ultë*".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, nenin 7, nenin 24 par. 2, nenin 56 par.1.1 dhe 1.2, nenin 59 par. 3 dhe 4, nenin 65 par 3.1 dhe 3.6 dhe par 4.1 deri 4.11, nenin 69 par 2.1 si dhe nenin 72 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 11.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 18.08.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues ku është rekomanduar që ankesa e OE ankues të refuzohet dhe vendimi i AK të mbetet në fuqi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, deklarimet e palëve dhe ekspertit në shqyrtimin kryesor, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor *në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim: "Bazuar në kriterin e dosjes së tenderit Autoriteti Kontraktues nuk ka cekur se sa kontrata duhet të kenë operatoret ofertues por vetëm se duhet të kenë projekte të realizuara brenda tre viteve të fundit. Operatori ekonomik i rekomanduar Patroni SHPK në dosjen e ofertës ka prezantuar listën e kontratave dhe kontratat e nënshkruara. Lista e kontratave përbëhet prej gjithsejtë tetë (8) kontratave. Sa i përket pretendimit se kontratat kanë përfunduar para datës së afatit të tyre sqarojmë se kontratat në bazë të LPP dhe RRPP përfundojnë në momentin që arrihen sasitë e furnizimeve ose arrihet vlera e kontratës pavarësisht kësaj se deri në cilën datë kanë afat kontratat. Po ashtu e njëjta gjë vlen edhe për kontratat e lidhura me sektorin dhe nga sektori privat. Mbështetur në kërkesën e AK të cekur në dosjen e tenderit lista e kontratave e plotëson kriterin e kërkuar po ritheksoj edhe njëherë kërkesën 1 përkatësisht listën e furnizimeve të ngjashme (derivateve) të operatorit ekonomik të realizuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit. Bazuar në këtë, lista e kontratave përmban pikërisht llojin e furnizimeve, produktin e furnizimit, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Andaj konstatoj se pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar".*

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim:"*Sa i përket dyshimeve ne vërtetësinë e dokumenteve, kontratave kjo nuk është në kompetencat e ekspertit shqyrtues por është përgjegjësi e autoritetit kontraktues*".

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor *në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim: "Çertifikata nga Gjykata dhe vërtetimi tatimor kërkohen vetëm për operatorin ekonomik fitues në rastin e shpalljes së rezultatit të prokurimit në rastet kur lëshimi i dokumenteve dhe çertifikatave që referohen më lartë është i pamundshëm për arsye objektive apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme, duhet pasur parasysh se operatori ekonomik në ofertë ka dorëzuar edhe deklaratën nën betim, pavarësisht kësaj operatori ekonomik së bashku me ofertën ka dorëzuar edhe vërtetimin tatimor dhe çertifikatën nga gjykata (të nxjerre nga e-Kosova në emrin e pronarit sipas çertifikatës së biznesit) si edhe deklaratën nën betim konform nenit 65 të LPP. Në bazë të RRPP nenit 25 pikës 25.9 afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Autoriteti kontraktues konform shkresës (e-mailit) me datën 01.08.2023 ka kërkuar nga ana e operatorit ekonomik që të sjell dokumentet (vërtetimin tatimor, çertifikaten e gjykatës dhe sigurimin e tenderit) fizikisht në zyrat e KEK. Bazuar në kërkesën e AK, operatori ekonomik i rekomanduar figuron që dokumentet e kërkuara i ka sjellur në AK brenda afateve ligjore të përcaktuara konform kërkesës. AK publikimin e njoftimit mbi vendimin e ka bërë konform dokumenteve të prezantuara në ofertë lidhur me vërtetimin tatimor dhe çertifikatën e gjykatës pasi që pronari ka dëshmuar se nuk ka ndonjë vepër penale ose civile ndaj tij. Po ashtu gjatë kërkesës se AK për të sjellur dokumentet sipas kërkesës së datës 01.08.2023 i njëjti ka dërguar edhe çertifikatën e gjykatës në emrin kompanisë që dëshmon se njëjta nuk ka ndonjë ndalesë ligjore ndaj kompanisë në fjalë. Lidhur me raportin e vlerësimit të miratuar nga ZPP mund të konsiderohet si gabim procedural por që i njëjti nuk përmban ndryshim material të përcaktuar me nenin 59 par.4. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë. Bazuar në këtë e konsideroj pretendimin ankimor si pjesërisht të bazuar. Por duhet theksojmë se OE i rekomanduar është përgjigjur atëherë kur AK ka kërkuar dokumentin në fjalë".*

Lidhur me pretendimin e katër (IV) ankimor *në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim: "Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe në specifkimin teknik nuk ka kërkuar që operatorët ekonomik në ofertim të dëshmojnë kapacitetin e makinerisë për bartjen e mazutit, po ashtu lidhur me kërkesën e AK operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar deklaratë me shkrim lidhur me plotësimin e kushteve dhe kërkesave që dalin nga aneksi nr.1 i DT si dhe ka bërë vërtetimin dhe nënshkrimin e specifikimit teknik. Duke pasur parasysh këtë konsideroj se operatori ekonomik në këtë pikë e plotëson kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar. Sa i përket pikës së pretendimit se AK është dashur të kërkoj sqarime për këtë pikë konstatoj se kjo çështje i përket autoritetit kontraktues që të vendos për sqarime ose jo sa i përket kërkesave të tij, por që vlen të theksojmë se AK në dosjen e*

tenderit nuk ka kërkuar Makineri për bartjen e Mazutit".

Lidhur me pretendimin e pestë (V) ankimor *në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim: "Në dosjen e tenderit në aneksin nr.1 autoriteti kontraktues ka cekur se OE përmes një deklarate duhet të deklarohet lidhur me vendin e origjinës së Mazutit dhe Prodhuesin. Operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar dy (2) deklarata me shkrim. Në këto deklarata nuk figuron teksti se nga është prejardhja e Mazutit të furnizuar, por në një dokument çertifikaten e kualitetit (Certificate of Quality) me Nr.219/2023/RE e datës 19.07.2023 theksohet se vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është HELPE lonia Thessaloniki dhe parimisht i bie që është edhe vendi i prejardhjes apo origjinës, po ashtu në këtë certifikatë theksohet edhe produkti i kërkuar që është FUEL OIL si dhe vendi i destinimit Kosovë. Mbetet në përgjegjësinë e autoritetit kontraktues që në bazë të nenit 59 të LPP që të bëj vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave që të vendos mbi pranueshmërinë apo jo të këtij dokumenti që ka të bëj me mazutin. AK ka vlerësuar konform nenit 59 dhe nenit 7 të LPP duke pasur parasysh se as operatori ekonomik ankues nuk ka dorëzuar deklaratën për prejardhjen e mazutit, kurse operatori ekonomik i rekomanduar siç potencuam edhe më lartë ka prezantuar çertifikatën e kualitetit që ceket edhe vendndodhja (lokacioni) i Mazutit. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues këtë pretendim e cilësoj si të bazuar".*

Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) ankimor *në raportin e ekspertit shqyrtues është përcaktuar si në vijim: "Në dosjes se tenderit te publikuar ne e-prokurim nga AK , njoftimit për kontratë si dhe Deklaratës se nevojave dhe përcaktimit te disponueshmeris se fondeve planifikimi buxhetit është 4,200,000.00 euro. Kurse oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar është 4,699,058.45 euro , 367,322.20 euro më e ulët se sa oferta e dytë (e OE Ex Fis) dhe pasur parasysh planifikimin e autoriteti kontraktues oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar nuk mundë që te konsiderohet në këtë rast si çmim ab-nomralisht i ulët dhe pretendimi ankimor për këtë është i pa bazuar. Ne bazë te RRPP Nr.001/2022 Neni 41 pika 41.3 nën pikat (i), (ii) dhe (iii) citohet: i.) çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii.) çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii.) janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Dhe bazuar ne këtë në as njërin variant nuk dëshmohet ne as një kalkulim se oferta është abnormalisht me çmimin e ulët".*

Me datë 04.10.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e palëve procedurale si dhe eksperti shqyrtues.

Përfaqësuesi i palës ankuese *gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar shkurtimisht se qëndron prapa pretendimeve ankimore duke shtuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues. Tutje gjatë seancës ka shtuar po ashtu se "në FDT Aneksi -1 AK ka kërkuar që OE përmes një deklarate duhet të deklarohet lidhur me vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin. Dokumenti Certificate of Quality si dhe Aneksi 1 i dosjes së tenderit i vulosur dhe nënshkruar nga OE i rekomanduar nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit për të treguar dhe garantuar kualitetin se mallrat e ofruar përmbushin kërkesat minimale të këtij aneksi. Po ashtu dokumenti Certificate of Quality tregon vetëm pikën ku është bërë inspektimi i ngarkesës e që*

është HELPE lonia Thessaloniki, pra po citojmë Location of loading / inspection (vendndodhja e inspektimit të ngarkimit) dhe jo vendin e origjinës dhe prodhuesin e mazutit. Se kjo çertifikatë nuk mund të merret valide për këtë tender e vërteton edhe fakti se kjo çertifikatë nuk i referohet kërkesave të këtij aneksi dhe këtij tenderi, por i referohet një sasie të caktuar mazuti (sasia prej 26,930 lirave) të blerë diku në një vend të pa identifikuar nga OE Patroni me dt. 19.07.2023 dhe të destinuar për një vend tjetër të papërcaktuar në këtë dokument. Prandaj për të qenë një çertifikatë valide për të plotësuar kërkesat teknike të mazutit sipas Ankesit-1 të DT, OE duhet të sjell një çertifikatë valide nga një prodhues i caktuar e konfirmuar nga një laborator i pavarur i licencuar, që vërteton prodhuesin, vendin e origjinës si dhe karakteristikat teknike të mallit të ofruar" .

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa njoftimit mbi vendimin të datës 01.08.2023 dhe ka kërkuar të refuzohet si e pabazuar ankesa. Tutje ka deklaruar se "*OE i propozuar për kontratë në ofertën e tij ka dorëzuar edhe një dokument me analiza fiziko-kimike në të cilin kuptohet vendi dhe origjina e lëndës djegëse-Mazutit*" Sa i përket deklaratës së kërkuar për Oe pjesëmarrës lidhur me vendin e origjinës dhe Prodhuesit, as OE Ankues nuk e ka sjell të njëjtën andaj për shkak të rëndësisë së këtij aktiviteti ne si AK i kemi marr të mirëqena që të dyja ofertat duke respektuar nenin 7 të LPP, dhe në këtë rast Oe i rekomanduar ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për ne dhe po ashtu ka çmim më të lirë se ofertuesi ankues rreth 367,322.20euro.

Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa të gjeturave dhe rekomandimeve të evidentuara në raportin e ekspertit shqyrtues. Megjithatë ka shtuar tutje se "*Deshta të sqaroj pasi që u lëshuam vetëm te pretendimi nr. 5 që e përmendi OE që ka qenë i bazuar në ekspertizë ka qenë një gabim teknik. Pretendimi ankimor ka qenë se nuk i dihet vendi i origjinës së mazutit dhe atë e kam shtjelluar dhe e kam pasqyruar në ekspertizë se OE i rekomanduar ka dy deklarata, ka vërtetimin se do e përmbush furnizimin dhe gjatë analizimit të saj kam gjetur një certifikatë të analizave laboratorike të bëra në MAK inspect në Maqedoni e cila tregon vend ndodhjen e mazutit që është në Selanik me destinim Kosovën dhe përmban vlera testuese sipas specifikimit teknik të kërkuar dhe kjo më ka lënë të kuptoj që vendi i origjinës është në Selanik të Greqisë por që në dosje të tenderit nuk është kërkuar autorizim i ndonjë prodhuesi*". Në vazhdën e kësaj deklarate, paneli shqyrtues ka parashtruar për ekspertin shqyrtues pyetjen vijuese "*a e konsideron të plotësuar kërkesën e vendosur nga ana e AK te aneksi 1 përmes së cilës ka kërkuar nga OE të dorëzojnë një deklaratë lidhur me vendin e origjinës së mazutit dhe prodhuesin*"? Eksperti përgjigjet se "*OE ka dorëzuar dy deklarata por që nuk shkruan në to vendi i origjinës e cila ka qenë pretendim ankimor kurse në raportin laboratorik i cili është në përputhshmëri me vlerat e kërkuara në specifikimin teknik ceket se mazuti i testuar është nga Selaniku dhe unë kam kuptuar se vendi i origjinës është në Selanik*". Tutje paneli shqyrtues ka parashtruar pyetjen shtesë si në vijim "*a je i sigurt kush është prodhuesi*"? Me këtë rast eksperti përgjigjet se "*jo nuk jam i sigurt kush është prodhuesi nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi*".

Në vijim paneli shqyrtues ka parashtruar pyetje edhe për përfaquesin e autoritetit kontraktues të formuluar si në vijim "*cili është vendi i origjinës dhe prodhuesi për OE të rekomanduar*"? Përfaqësuesi i AK është përgjigjur si në vijim "*OE ankues deklaroj se OKTA është prodhues dhe në të njëjtën kohë deklaron se në dokumentin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është e cekur kompania OKTA. OE ankues deklaron se nuk ka dorëzuar deklaratën për vendin e origjinës dhe prodhuesin por ka dorëzuar një autorizim të lëshuar nga OKTA që nëse bazohemi në këtë autorizim në paragrafin e fundit ceket me qenë se kontrata nuk është e lidhur ekskluzivisht me oktën dhe nuk e bëjmë transportin te KEK nuk garantojmë për kualitetin dhe sasinë e dorëzuar nga EX FIS shpk. AK mendon se furnizimi duhet të bëhet nga OKTA me qenë se ceket në dokumentin e dorëzuar me analiza fiziko kimike nga OE i rekomanduar për kontratë*".

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdes profesional i ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 59 të LPP, përderisa nuk i ka përdorur apo zbatuar me kohë dhe gjatë rrjedhës së aktivitetit kompetencat e tij në vështrim të paragrafit 2, të dispozitës së cituar sipas së cilës AK mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Nga pikëpamja e Panelit dhe në kuptim të hulumtimeve të eksperti shqyrtues mund të konstatohet se, informacionet shtesë kanë qenë në fakt të nevojshme që për hire të vlerës së tenderit, rëndësisë dhe qëllimit të prokurimit të vërtetohen në mënyrë të pakontestueshme faktet përkitazi me deklaratën e prodhuesit dhe origjinën e artikullit nga ana e operatorëve ekonomik, meqë të njëjtat krijojnë ndikim qenësor në ketë aktivitet të prokurimit për arritjen e qëllimit për përmbushjen e nevojave. Dhe krahas kësaj, Paneli konsideron se në procesin e rivlerësimit, kërkohet nga AK që dokumentin e prezantuar nga OE i rekomanduar ta verifikoj ngase i njëjti përmban apo jo të dhëna dhe/ose informacione të qarta mbi prejardhjen dhe prodhuesin e mazutit, gjithnjë duke u nisur nga fakti se nuk ishte kontestuese për palët në procedurë që të dy OE pjesëmarrës në këtë aktivitet (*nënkupto:* OE i rekomanduar dhe OE Ankues) nuk kanë paraqitur një deklaratë të tillë, kurse si kriter i tillë "deklarata kontestuese" nuk ishte e vendosur në kuadër të kritereve kualifikuese por ishte është kërkuar tek aneksin 1 i DT.

Paneli në këtë rast ka konstatuar se mungesa e kësaj deklarate në raport me efektet qenësore të sajë janë konsideruar nga AK si "devijim i vogël" në kuptim të nenit 59.4 lidhur me nenet 8 dhe 9 të LPP, megjithatë sipas gjykimit të tij të pavarur e në vështrim të dispozitave të nenit 1 dhe 6 të LPP, Paneli vlerëson se në këtë rast AK është e obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të aplikojë nenin 52 dhe 72 të LPP për të kërkuar informata shtesë nga ana e OE-të lidhur me origjinën dhe prodhuesin e mazutit, meqë artikulli në rastin konkret e shpreh dhe përcakton qëllimin e prokurimit dhe shfrytëzimin e fondeve publike në ketë rast. Në fakt Paneli konsideron se mungesa e të dhënave të sakta përkitazi me dokumentet e cituara, si të ankuesit po ashtu dhe të operatorit ekonomik të rekomanduar, e vejnë padyshim në dilemë secilin Panel lidhur me faktin nëse vendimi i atakuar duhet mbetur në fuqi, përderisa e gjithë kjo zbrazëtirë informacionesh kanë mundur të mbulohet brenda një kohe efektive.

Duhet shtuar po ashtu se me rastin e trajtimit të pretendimit nr. 6 përmes analizimit të raportit të ekspertit dhe deklarimit të përfaqësuesit të autoritetit kontraktues në seancën e shqyrtimit kryesor, Paneli Shqyrtues ka gjetur se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është 4,200,000.00 euro. Të dy operatorët ekonomik që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit e kanë tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar. Prandaj me rastin e rivlerësimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit, AK duhet të konfirmoj nëse operatori ekonomik i rekomanduar i posedon vërtetë kapacitetet për të proceduar tutje me aktivitetin e prokurimit për shkak të shumave që kanë ofertuar tenderuesit përkatës, në kuptim të nenit 1 dhe 6 të LPP. Përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se "*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...".* Përmes nenit 6 të LPP përcaktohet se "*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*" ndërsa lidhur me pretendimet tjera paneli shqyrtues e mbështet raportin e ekspertit shqyrtues.

Përfundimisht Paneli Shqyrtues bazuar në të lartcekurat thekson që AK me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të ofertave duhet të kërkoj sqarime shtesë nga ofertuesit në kuptim të nenit 72 të LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 38.1 të RRPP. Përmes nenit 72 të LPP përcaktohet se "*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji*". Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet se "*Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja bëhen përmes platformës elektronike*".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **Ex Fis**
- Arkivës së OSHP-së: